



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 21/18  
Prishtinë, më 30.3.2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajçi, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Dardan Molliqaj, Naser Osmani dhe Blerim Kuçi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurie Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, kryetar i komisionit (tutje: kryetari).

**Rendi i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-034, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
5. **Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** - konstatoi se rendi i ditës u miratua unanimisht, pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim**

**Kryetari**, theksoi se komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje dhe ne në pajtim me Vendimin e Kuvendit duhet të procedojë Raportin për shqyrtim të dytë në seancën plenare. Por, kam dy propozime në amendamentet e komisionit. Propozojë që të fshihet amendamenti 5, pasi që pas konsultimeve me zyrën ligjore, kemi mësuar se kompetenca për nxjerrjen e

akteve nënligjore mund ti mbetet KKRF-së nëse përcaktohet me ligj dhe prandaj ne e fshijmë amendamentin dhe teksti mbetet siç është në projektligj. Po ashtu, propozojë që amendamenti 23 të ndryshojë dhe të thuhet se fshihet neni 39 i projektligjit, pasi që me amendamentin 38 është përcaktuara se aktet nënligjore të reja që do të nxjerren në bazë të këtij ligji, do ti zëvendësojnë ato që janë të zbatueshme në momentin që do të nxjerren dhe nuk ka nevojë që të mbetet neni 39.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi propozimet për heqjen e amendamentit 5 dhe ndryshimin e amendamentit 23, me të cilin thuhet se fshihet neni 39.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Raportin me amendamente për Projektligjin nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, me heqjen e amendamenti dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim në Kuvend.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

**Kryetari** - theksoi se Projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore dhe rekomandoj që ta përkrahim atë dhe ta procedojmë me rekomandim, më tutje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-034, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

**Kryetari** - theksoi se Projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore dhe rekomandoj që ta përkrahim dhe ta procedojmë më tutje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr.06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-034, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:20.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit.**

**Kryetar i komisionit,**

-----  
**Lumir Abdixhiku**